

Vendim nr. 19 datë 03.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Holta Zaçaj,	Anëtare

në datën 03.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (SH) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SHOQËRIA “SIGMA INTERALBANIA VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-2058 (194), datë 25.10.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 27 e në vijim i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet që shoqërojnë kërkesën rezulton se shoqëria “Fisheku” sh.a. është person juridik që ushtron aktivitet tregtar në fushën e tregtimit me shumicë, import-eksportit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Në periudhën 23.12.2005 - 10.02.2006 ajo ka kryer aktivitet tregtar në importimin e lëndëve djegëse, importe të kryera në 191 raste nëpërmjet pikës doganore të Qafë-Thanës. Sipas deklaratave doganore mbi bazën e kodit tarifor përkatës, janë llogaritur dhe paguar nga kjo shoqëri detyrimet doganore të importit dhe më pas malli i importuar ka kaluar nën regjimin e qarkullimit të lirë.

2. Për të gjitha rastet e mësipërme autoritet doganore kanë marrë mostra të mallit të importuar, me qëllim verifikimin e saktësisë së deklaratës doganore të mallit të deklaruar dhe verifikimin e saktësisë së detyrimit doganor të llogaritur e paguar nga shoqëria “Fisheku”.

3. Autoritetet doganore, përpara lejit të mallit të importuar nën regjimin e qarkullimit të lirë, bazuar në nenin 204, pika 1, të Kodit Doganor, kanë kërkuar nga shoqëria “Fisheku” sh.a. dhënien e garancisë me qëllim sigurimin e pagesës së borxhit doganor që mund të rezultonte në rast pasaktësie të deklaratave doganore që do të çonin në rillogaritje të detyrimeve doganore të importit, si dhe penaliteteve për deklarim të pavërtetë.

4. Rezulton se shoqëria “Fisheku” sh.a. i ka paraqitur palës paditëse garanci në formën e pagesës së barazvlefshme me depozitën në të holla (sipas neneve 208, shkronja (a) dhe 209, pika 2, të Kodit Doganor), garanci këto të siguruara nga Shoqëria e Sigurimeve “Interalbanian” sh.a. dhe që janë pranuar nga autoritetet doganore në përputhje me nenin 204, pika 3, të Kodit Doganor.

5. Referuar importeve të mallrave të kryera nga shoqëria “Fisheku” sh.a. prej Shoqërisë “Interalbanian” sh.a. janë dhënë disa garanci në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave/Dega e Doganës Qafë-Thanë, akte sigurimi garancie këto që mbajnë nënshkrimin e përfaqësuesve të këtyre dy shoqërive, me emërtimin “certifikatë garancie për sigurim kontrate”. Konkretisht, shoqëria “Interalbanian” sh.a. ka siguruar garancitë e dhëna nga shoqëria “Fisheku” sh.a. në lidhje me pagesën e një borxhi doganor që mund të rezultonte për këtë shoqëri pas kryerjes së analizave nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës dhe Gazit (*ISHKNG*), duke lëshuar certifikatat e garancisë përkatëse.

6. Duke qenë se shoqëria “Fisheku” sh.a. ka marrë përsipër të ushtrojë aktivitetin import-eksport për importin e lëndës djegëse (heating oil), për ushtrimin e këtij aktiviteti i është kërkuar nga dogana e Qafë-Thanës garanci për detyrimin doganor deri në përgjigjen e analizave. Shoqëria “Interalbanian” sh.a. ka marrë përsipër lëshimin e këtyre certifikatave me kërkesë të shoqërisë “Fisheku” sh.a. për të mbuluar përmbushjen e garancisë në shumat respektive në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave/Dega e Doganës Qafë-Thanë, për çdo shkak të mundshëm.

7. Mostrat e mallit të importuar nga shoqëria “Fisheku”, përpara zhdoganimit të mallit, i janë nënshtruar analizave nga ISHKNG -ja për verifikimin e llojit të mallit dhe klasifikimi tarifor në laboratorin kimik doganor. Ndërkohë që ky laborator nuk kishte lëshuar zyrtarisht përgjigjet/certifikatat përkatëse të verifikimit, i është kërkuar përsëri shoqërisë “Fisheku” sh.a. dhënia e një garancie të përgjithshme, për shumën totale sipas “certifikatave të garancisë” të deriatëhershme, për shumën 70.000.000 lekë, me qëllim sigurimin e pagesës së borxhit doganor që mund të rezultonte në rast pasaktësie të deklaratave doganore.

8. Kërkuesja, shoqëria “Interalbanian” sh.a. ka lëshuar një certifikatë garancie për sigurim kontrate për shumën 70.000.000 lekë me të njëjtën përmbajtje si dhe certifikatat e garancisë.

9. Në datat 24.02.2006, 02.03.2006 dhe 06.03.2006 laborator kimik doganor ka nxjerrë përgjigjet/certifikatat e verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor, ku për 66 raste importi të shoqërisë “Fisheku” sh.a. ka arritur në përfundimin se malli i importuar nuk ka qenë lëndë djegëse sipas kodit tarifor që shoqëria kishte deklaruar, por gazoil, mall ky me një kod tarifor të ndryshëm nga ai i deklaruar prej kësaj shoqërie në momentin e zhdoganimit të mallit.

10. Dega e Doganës Pogradec, me shkresën nr. 456 prot., datë 21.03.2006, i ka kërkuar shoqërisë “Interalbanian” sh.a. xhirimin vullnetar të shumës sipas certifikatës së garancisë nr. 21, datë 04.03.2006, pasi sipas verifikimeve të bëra nga laboratorik kimik doganor kishte rezultuar që në 66 raste importi nga shoqëria “Fisheku” sh.a. malli i importuar ka qenë gazoil dhe jo lëndë djegëse, duke iu shmangur ky subjekt detyrimit doganor në shumën 70.654.421 lekë, pa llogaritur sanksionet e mundshme.

11. Po ashtu, Dega e Doganës Pogradec, me vendimin nr. 30, datë 25.03.2006, referuar rezultatit të analizave të laboratorik kimik doganor, bazuar në nenin 261 të Kodit Doganor, ka vendosur, që shoqëria “Fisheku” sh.a. të paguajë detyrimet doganore në shumën 60.132.439 lekë, si dhe ta dënojë atë administrativisht me gjobë në shumën 180.397.317 lekë. Ky vendim për

përmbushjen e detyrimit i është komunikuar shoqërisë “Interalbanian” sh.a. me shkresën nr. 456/1 prot., datë 25.03.2006.

12. ISHKNG-ja, me shkresën nr. 378 prot., datë 11.04.2006, i ka dërguar kërkuases përgjigjet e analizave bashkë me certifikatat e cilësisë së produktit, sipas të cilave malli i importuar nga shoqëria “Fisheku” sh.a. ishte gazoil industrial, brenda standardit dhe i lejuar për t’u zhdoganuar.

13. Shoqëria “Interalbanian” sh.a., me shkresën nr. 113 prot., datë 20.04.2006, i ka kthyer përgjigje Degës së Doganës Pogradec se nuk kishte detyrim për t’i paguar shumën 70.000.000 lekë në kushtet kur *“Sipas Certifikatës së Garancisë nr. 21, datë 04.03.2006, kishte dalë garant për Shoqërinë “Fisheku” sh.a “deri në përgjigjen e analizave nga ISSHK-ja” dhe jo nga “Laboratori Kimik Doganor”*. Referuar vendimit nr. 30, datë 25.03.2006 të Degës së Doganës Pogradec, shmangia e detyrimeve doganore nga shoqëria “Fisheku” i përkiste periudhës (05.01.2006 - 10.02.2006), pra përpara lëshimit të certifikatës së garancisë, e cila, sipas nenit 1124 të Kodit Civil, kishte hyre në fuqi në datën 04.03.2006, duke qenë e vlefshme deri në datën 03.04.2006.

14. Në datën 14.04.2006 shoqëria “Fisheku” sh.a. ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me palë të paditur Degën e Doganës Qafë-Thanë Pogradec, duke kërkuar *“pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 30, datë 25.03.2006 të Degës së Doganës Pogradec”*.

15. Po ashtu, në datën 15.05.2006 Dega e Doganës Pogradec i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ka kërkuar detyrimin e kërkuases për t’i paguar shumën prej 70.000.000 lekësh si detyrim kontraktual sipas certifikatës së garancisë së lëshuar prej saj për garantimin e detyrimeve doganore të subjektit “Fisheku” sh.a. Shoqëria “Interalbanian” sh.a. i ka kërkuar gjykatës së shkallës së parë pezullimin e gjykimit.

16. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3680 datë 23.04.2008, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë”* si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim, Dega e Doganës Pogradec, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e padisë.

17. Me vendimin nr. 835, datë 09.04.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 3680, datë 23.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Dega e Doganës Pogradec, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.02.2014.

18. Në datën 01.08.2014 shoqëria “Interalbanian” sh.a. ka nisur procedurën për t’u bashkuar me shoqërinë “Sigma Vig” sh.a. dhe në tetor të këtij viti ka përfunduar procedura e bashkimit me përthithje e shoqërisë “Sigma Vig” sh.a. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj shoqërie kanë kaluar te shoqëria përthithëse me emërtimin “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a.

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2021-2058 (194), datë 25.10.2021, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 3680, datë 23.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 835, datë 09.04.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pranimin e padisë. Detyrimin e palës së paditur, shoqëria “Interalbanian” sh.a. që të paguaj në favor të palës paditëse Dega e Doganës Pogradec shumën prej 70.000.000 lekë. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e tij”*.

20. Në datën 01.12.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkeses

21. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, duke pretenduar se janë cenuar:

22.1. *E drejta e aksesit në gjykatë dhe e drejta për t’u njoftuar*, pasi kërkesja nuk ka pasur dijeni për këtë proces gjyqësor të zhvilluar në shkallë të parë dhe apel dhe se në momentin e përthithjes shoqëria “Interalbanian” sh.a. nuk kishte asnjë detyrim ndaj Degës së Doganës Pogradec. Gjykata e Lartë, megjithëse ka gjykuar në vitin 2021 një çështje të regjistruar në vitin 2014, nuk ka bërë asnjë përpjekje për të njoftuar palën e paditur për orën dhe datën e gjykimit. Gjykata e Lartë nuk ka njoftuar jo vetëm shoqërinë “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., por as shoqërinë “Interalbanian” sh.a. megjithëse kjo e fundit nuk kishte personalitet juridik në momentin e gjykimit.

22.2. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi kërkesja nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në Gjykatë të Lartë, për pasojë ajo është vendosur në kushte jo të barabarta me palën kundërshtare. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar dhe vlerësuar çështjen vetëm mbi pretendimet e subjekteve të interesuara, në mënyrë të njëanshme, duke shkelur kontradiktoritetin në gjykim.

22.3. *Parimin e sigurisë juridike dhe të disponibilitetit*, pasi Gjykata e Lartë ka gjykuar mbi një kërkim të objektit të padisë, i cili nuk është ngritur prej saj dhe me këtë deformim që i ka bërë objektit të gjykimit ka dalë jashtë kufijve të shqyrtimit të çështjes. Ajo ka disponuar mbi një kërkim që nuk i është nënshtruar hetimit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

22. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

23. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shtetimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

24. Kërkesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

25. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkesja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-2058 (194), datë 25.10.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 28.12.2022, pra pas 1 viti e 2 muajsh. Në kërkesë ajo ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 02.08.2022, me anë të shkresës së

përmbaruesit “Lajmërim për ekzekutimin vullnetar” për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Bashkëlidhur kërkesës kërkuësja ka paraqitur edhe një kopje të kësaj shkrese.

26. Në rastin konkret, sipas dokumenteve bashkëlidhur dosjes gjyqësore, të administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, Kolegji vëren se rekursi është paraqitur në datën 06.05.2013 nga Dega e Doganës Pogradec. Ai i është njoftuar shoqërisë “Interalbanian” sh.a. në datën 03.07.2013 dhe është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.02.2014. Më tej, Gjykata e Lartë ka njoftuar me shpallje palët sipas ligjit për hapat proceduralë të ndjekur prej saj. Me anë të vendimit të datës 08.02.2017, Kolegji Administrativ ka njoftuar shtyrjen e seancës gjyqësore (dhomë këshillimi) për një datë tjetër me shpallje deri në plotësimin e trupit gjykues. Me vendimin e datës 18.04.2017, është caktuar shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi për në datën 10.05.2017, dhe më pas është vendosur shtyrja në seancë gjyqësore (dhomë këshillimi) për në datën 24.05.2017. Po në këtë datë është vendosur shtyrja e seancës për t’ia nënshtruar dosjen gjyqësore procedurës së shortimit me qëllim plotësimin e trupës gjyqësore. Në datën 17.10.2017 ky Kolegj ka vendosur të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve ndërgjyqëse, duke njoftuar shtyrjen e seancës gjyqësore për një ditë tjetër me shpallje. Kolegji Administrativ ka vendosur revokimin e vendimit të datës 17.10.2017 për caktimin e çështjes në seancën gjyqësore dhe kthimin për shqyrtim në dhomë këshillimi, si dhe ka caktuar për shqyrtim çështjen në datën 25.10.2021.

27. Po ashtu, Kolegji konstaton se referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se kjo e fundit ka shpallur publikisht pranë ambienteve të saj listën e çështjeve të cilat do të shqyrtoheshin në datën 25.10.2021, ku përfshihej edhe çështja e kërkuësës. Pas këtij njoftimi, Gjykata e Lartë ka njoftuar në faqen e saj zyrtare përfundimin e gjykimit për çështjen e kërkuësës, duke publikuar edhe vendimmarrjen e saj. Në të gjitha njoftimet e kryera është vendosur si palë e paditur shoqëria “Interalbanian”. Ndërkohë nga dosja gjyqësore nuk rezulton që kërkuësja të ketë depozituar pranë Gjykatës së Lartë aktin e përthithjes së shoqërisë “Interalbanian” sh.a. tek shoqëria “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a.

28. Në vështrim të rrethanave të mësipërme, përderisa shoqëria “Interalbanian” sh.a është njoftuar rregullisht për rekursin e ushtruar nga Dega e Doganës Pogradec dhe duke qenë se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “Interalbanian” sh.a. kanë kaluar te shoqëria përthithëse me emërtimin “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., Kolegji vlerëson se kërkuësja ka qenë në dijeni të procesit në Gjykatën e Lartë dhe kishte interesin të ndiqte fatin e procesit të saj. Në këtë drejtim, paraqitja e shkresës së zyrës së përmbarimit, me të cilën ajo pretendon se është vënë në dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë vetëm në datën 02.08.2022,

nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht për këtë vendim. Gjithashtu, Kolegji vëren se në kërkesën e saj kërkuësja ka paraqitur argumente kontradiktore pasi, nga njëra anë, pretendon se nuk kishte dijeni për ekzistencën e këtij procesi dhe, nga ana tjetër, parashtron se *“në mënyrë periodike ka ushtruar kontrollin e saj në lidhje me ecurinë e çështjeve për të cilat janë paraqitur rekurse pranë Gjykatës së Lartë”*.

29. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se data e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual do të konsiderohet data 17.02.2021 e vendimit të fundit gjyqësor të kundërshtuar, atij të Gjykatës së Lartë dhe se kërkesa drejtuar Gjykatës është paraqitur dukshëm në tejkalim të këtij afati. Për këtë arsye, kërkuësja nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues dhe kërkesa e paraqitur prej saj nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.